



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË



Data: 01.06.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Shtrim me asfalt miks i rrugëve të Njësive administrative, Bashkia Korçë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për rrugë 45233120-6

VLERA E FONDIT LIMIT:

**69 830 184.24 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e tridhjetëmijë e njëqind e tetëdhjetë e katër pikë
njëzet e katër) lekë pa tvsh**

Ky objekt është parashikuar të financohet nga të Ardhurat e Bashkisë Korçë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA KORÇË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi tpublik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e përllogaritur e kontratës që prokurohet. që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në **ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat**), Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje **Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat"**: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023,2024,2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, Kreu V, neni 41, gërma b) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 61 të Ligjit nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor **jo më vonë se data 31 mars** e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklaratan sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. 5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. **Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare**, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 gërma b) të Ligjit nr. 1009/2009: "Njësitë ekonomike që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare" Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

-
- totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;
 - shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;
 - ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.
-

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël** se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat

50 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" ku qartazi përcaktohet se: **"Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

Lidhur me dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e punëve të ngjashme janë kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve."

Ne kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit apo marrëveshjes së nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Dokumenta keto të nevojshme për të vlerësuar lidhur me punët konkrete që ka kryer OE si anëtar i BOE, apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka

përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Licenca duhet të përmbajë kategoritë e punimeve të kontratës si më poshtë:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
-----------	-------------	-----------------------

N.P – 1	A	Punime gërmimi në tokë
---------	---	------------------------

N.P – 4	C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
---------	---	---

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga specialist i fushës i argumentuar në procesverbalin e mbajtur prej tij **date 29.05.2026 si më poshtë:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* të ndryshuar, neni 8 përcakton *“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.*

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1	Punime gërmimi në tokë	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Transport dheu me auto deri 5.0 km	A, 0-20 milionë lekë	1,515,549.04 lekë
N.P-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Shtrese stabilizant t=10cm Shtrese asfalt miks t=6cm	C, 51 – 100 milion lekë	64,989,388.33 lekë

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

➤ **Inxhinier Ndërtimi 1 (një)**

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës e vlefshme

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga specialist i fushës i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij date 29.05.2026 si me poshte: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj", VKM Nr 42 date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, si dhe ligjin 8402 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit",i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin kryesor të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të zberthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Konkretisht:

Kerkesa per drejtuesin teknik "**Inxhinier Ndertimi**" eshte vendosur duke u bazuar ne ligjin 8402 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier,Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit",i ndryshuar.

Bazuar ne zerat e punimeve te parashikuara ne preventiv nevojitet nje drejtues teknik me profesion **ing.ndertimi** i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

ARGUMENTIMI STAFI DREJTUES

Punimet apo veprimtarite konkrete per tecilat kerkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

Inxhinier Ndërtimi	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Transport dheu me auto deri 5.0 km Shtrese stabilizant t=10cm Shtrese asfalt miks t=6cm
--------------------	--

2.3.4 Operatori ekonomik, per realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë dhe **stafin mbështetës**, (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) te perfshire ne listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

➤ **1 (një) Inxhinier Topograf**

Për stafin e sipërcituar të paraqitet:

- I. Diploma
- II. Kontrata e punes e vlefshme

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga specialist i fushës i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij date **29.05.2026** si me poshte: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. **Inxhinieri topograf është kërkuar me qëllim realizimin e rëlvimeve topografike te domosdoshme gjatë zbatimit, referuar projektit te zbatimit dhe**

specifikimeve teknike. Vendosja e këtij kriteri është e justifikuar, pasi për zbatimin e saktë të punimeve nevojitet përkrahimi i objektit në terren në përputhje me të dhënat teknike dhe koordinatat e projektit, proces që mund të kryhet vetëm nga një topograf i kualifikuar.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **13 persona**, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin".

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion mbi 10 ton	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Kamion 5-10 ton	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Eskavator me goma	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Greider	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Autobot	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Tokmak elektrik	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Autobitumatriçe	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Asfaltoshtuese	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Rrul	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Nyje thyerje materialesh inerte	Cope 1	ne pronesi, me qira ose kontrate furnizimi
Fabrike asfaltobetoni	Cope 1	ne pronesi, me qira,ose kontrate furnizimi

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike duhet te paraqiten dokumentat si më poshtë :

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, ne rast se mjeti është ne pronesi te paraqiten: certifikata e pronesisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe certifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, ne rast se mjeti është me qera te paraqiten: kontrata e qerash vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikatën e pronesisë, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe certifikatë për transport mallrash brenda vendit, per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

(Ne rastin e mjeteve te marra me qira nga operatorët ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022, referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, certifikate e transportit te mallrave), mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet)

-Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk shenohen ne regjistra publik ofertuesi duhet te paraqesë dokumente qe vertetojne pronesine e mjeteve/pajisjeve dhe ne rast se jane me qera duhet te kontrata e qerash vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine e tyre.

➤ Per Nyjen e thyerjes te materialeve inerte:

Ne rast se është **ne pronesi** duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine, planvendosjen e nyjes, lejen mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Ne rast se Nyja e thyerjes është **me qera** duhet te paraqitet kontrata e qerash, vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e nyjes, planin e vendosjes te nyjes dhe lejen mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Ne rast se nuk ka ne pronesi apo me qera Nyje te thyerjes te materialeve inerte duhet te paraqitet kontrata paraprake e furnizimit me prodhuesin, e vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontrates, e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e saj.

➤ Për Fabrikën e asfaltobetonit:

Ne rast se është **ne pronesi** duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, planvendosjen e saj dhe lejen mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit është me **qera** duhet te paraqitet kontrata e qerash, e vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e saj planvendosjen e saj dhe lejen mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk është ne pronesi apo me qera, duhet te paraqitet kontrate furnizimi paraprake me prodhuesin e vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontrates, e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e saj.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi i kriterëve 2.3.5 dhe 2.3.6: Keto kritere u vendosen nga specialist i fushës i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij date 29.05.2026 si me poshte: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç ku përcaktohet se "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit" dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se „Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin minimal te punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, është zbatuar legjislacioni i fushës, konkretisht VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" dhe gjithashtu jam bazuar edhe në rekomandimin e APP Nr 1797/1 datë 10.03.2022 janë parashikuar orët e punës për secilin zë punimesh sipas tabelës bashkelidhur dhe bazuar edhe ne afatin e percaktuar ne grafikun e punimeve është percaktuar numri minimal i punonjesve te domosdoshem per realizimin e punimeve.

Numri i fuqisë punëtore është llogaritur ne baze te zberthimit te grafikut te punimeve, zberthimit te preventivit dhe natyres se objektit, numri prej 13 personash përfshin personelin kryesor drejtues teknik dhe punëtorë të tjere përlllogaritur nga zbërthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushes rezulton se:

Sasia totale e oreve te punes sipas manualit dhe analizave teknike për cdo zë të preventivit është **17,952.67** ore. Llogaritja e numrit te punonjesve ne varesi te oreve te punes dhe afatit te kontrates është si me poshte:

Totali orë pune + orë makineri	17,952.67
Ditë pune (orë pune/8)	2,244.08
Specialiste+punetore per 10 muaj	11

Ing. ndërtimi	1
Ing. topograf	1
Numri i punëtorëve gjithsej	13

Argumentim: Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:

Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyrën dhe volumnin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Gjithashtu bazuar në nenin 28 të Udhezimit Nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar, “Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit”

Kërkesa për paraqitjen e një kontrate **paraprake** furnizimi me prodhuesin e materialeve inerte ose të asfaltobetonit është vendosur me qëllim garantimin e disponueshmërisë së burimeve të nevojshme për realizimin e kontratës publike, pa i detyruar operatorët ekonomikë të lidhin kontrata përfundimtare furnizimi përpara shpalljes së fituesit.

Nëse do të kërkohej një kontratë përfundimtare furnizimi, operatorët ekonomikë do të vendoseshin në një marrëdhënie kontraktore që krijon detyrime reciproke për palët, pavarësisht faktit se rezultati i procedurës së prokurimit nuk është ende i njohur. Në rast se operatori ekonomik nuk shpallet fitues, ai do të mbetet i lidhur me një kontratë të vlefshme, duke marrë përsipër detyrime të panevojshme dhe kosto të mundshme që nuk lidhen me ekzekutimin e një kontrate publike.

Për këtë arsye, është kërkuar vetëm një kontratë paraprake furnizimi, e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës në rast shpalljeje fitues, e cila shërben si provë e aftësisë së operatorit ekonomik për të siguruar furnizimin e nevojshëm.

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia	Argumentimi
Kamion mbi 10 ton	Cope 2	ne pronesi ose me qira	Kërkohej për realizimin e zërave “Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5 km”, “Transport dheu me auto deri 5 km”, si dhe për furnizimin me material stabilizant dhe asfalt. Sasia 3 justifikohet për të siguruar vazhdimësi punë ndërmjet gërmimit, transportit dhe shtrimit

			të materialeve.
Kamion 5-10 ton	Cope 2	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për transport materialesh në ambiente me akses më të kufizuar ose për mbështetje logjistike gjatë furnizimit të kantierit me materiale ndërtimi dhe largimit të dheut nga gërmimet.
Eskavator me goma	Cope 2	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për realizimin e zërit “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi >2 m, tokë zak., kategoria III, me shkarkim në mjet”. Sasia 2 justifikohet për të siguruar vazhdimësi pune referuar zerave të preventivit dhe grafikut të punmeve
Greider	Cope 2	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për profilimin, nivelimin dhe përhapjen e materialit në zërin “Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”, si dhe për realizimin e shtresës së asfaltit. Sasia 2 justifikohet për të siguruar vazhdimësi pune referuar zerave të preventivit dhe grafikut të punmeve
Autobot	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për lagjen e shtresave gjatë realizimit të mbushjeve dhe shtresës stabilizant, me qëllim arritjen e lagështisë optimale për ngjeshje sipas kërkesave

			teknike të zbatimit. Sasia 1 justifikohet për të siguruar vazhdimësi pune referuar zerave të preventivit dhe grafikut të punimeve
Tokmak elektrik	Cope 2	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për ngjeshje lokale në zona ku rulët nuk kanë akses, kryesisht pranë kanaleve, skajeve të rrugës ose në punime plotësuese të mbushjeve. Numri 2 siguron vazhdimësi pune në fronte të ndryshme pune.
Autobitumatriçe	Cope 2	ne pronesi ose me qira	mjeti i nevojshem i specializuar për realizimin uniform të shpërndarjes së emulsionit bituminoz. Numri 2 siguron vazhdimësi pune në fronte të ndryshme pune
Asfaltoshtruese	Cope 2	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për realizimin e zërit "Shtresë asfalt miks t=6 cm", për garantimin e shtrimit uniform të asfaltobetonit sipas parametrave teknikë të projektit. Numri 2 siguron vazhdimësi pune në fronte të ndryshme pune.
Rrul	Cope 2	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për ngjeshjen e mbushjeve, shtresës stabilizant dhe shtresës asfaltike. Numri 2 siguron vazhdimësi pune në fronte të ndryshme pune
Nyje thyerje materialesh	Cope 1	ne pronesi, me qira ose	Justifikohet për sigurimin

inerte		kontrate furnizimi	e materialit inert për shtresën stabilizant dhe mbushjet. Duke qenë se preventivi përmban shtresë stabilizanti
Fabrike asfaltobetoni	Cope 1	ne pronesi, me qira,ose kontrate furnizimi	Kërkohet për prodhimin dhe furnizimin e asfaltobetonit për zërin “Shtresë asfalt miks t=6 cm”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent)
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent)
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent)

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Ne rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Dokumentacioni teknik ku perfshihen Specifikimet Teknike, Preventivi, Grafiku i Punimeve, Planimetritë dhe Planvendosjet për këtë objekt janë dorëzuar nga **Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës**, pjese perberese e struktures se Bashkise Korçë, në përputhje me detyrat e saj funksionale.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b, dhe nenit 36 të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*” i ndryshuar.

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjate hartimit te specifikimeve teknike jane marre ne konsiderate kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese të përcaktuara në aktet në ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili është publikuar se bashku me dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT